

“Të drejtat e nënave që ushqejnë me gji”



Të zgjedhësh mënyrën se si do ta ushqesh beben e re është një nga vendimet më të rëndësishme që do të merrni teksa përgatiteni për ardhjen e të voglit tuaj. Doktorët thonë se për pjesën më të madhe të femrave, ushqyerja me gji është mënyra më e sigurt dhe e shëndetshme. Është e drejta juaj të informoheni mbi perfitimet e ushqyerjes me gji dhe që ofruesi i kujdesit shëndetësor dhe shërbimet shëndetësore të nënës të inkurajojnë dhe mbështesin ushqyerjen me gji. Ju keni të drejtën të beni zgjedhjen tuaj për ushqyerjen me gji. Edhe nëse zgjidhni të ushqeni fëmijën me gji ose jo, ju keni të drejtat tuaja bazë, pavarësisht racës, besimit, kombësisë, orientimit seksual, identitetit gjinor apo burimit të të ardhurave për kujdesin shëndetësor. Qendrat e kujdesit të nënave kanë përgjegjësi të sigurohen që ju i kuptoni këto të drejta. Ato duhet ta sigurojnë këtë informacion në mënyrë të qartë për ju dhe të kenë një interpretues nëse është e nevojshme. Këto të drejta mund të kufizohen në rastet kur e kërkon shëndeti juaj ose i fëmijës. Nëse ndonjë nga të mëposhtmet nuk janë në përputhje me shëndetin tuaj ose të fëmijës, ju duhet të merrni informacion të plotë mbi faktet dhe të konsultoheni.

(1) Para lindjes:

Nëse ju jeni duke marrë mësimet prenatale mbi lindjen e fëmijës të siguruara nga qendrat e kujdesit të nënës dhe të gjitha klinikat spitalore, qendrat diagnostikuese dhe trajtuese që ofrojnë shërbime para lindjes në përputhje me pikën 28 të ligjit publik mbi shëndetin, ju duhet të merrni Deklaratën e Të drejtave të Nënave që Ushqejnë me gji. Cdo qendër shëndetësore duhet të japi fletëpalosjen me informacionin mbi lindjet, përfshi këtu edhe Deklaratën e Të drejtave të Nënave që ushqejnë me gji, në përputhje me seksionin 2800 3-i të këtij kapitulli, secilit pacient apo perfaqësuesit të caktuar, në momentin e rezervimit apo të pranimit në një qendër kujdesi shëndetësor për nënat. Cdo qendër kujdesi shëndetësor për nënat duhet ti japë një kopje të Deklaratës pacientit para ose në kohën mjekësore të përshtatshme.

Ju keni të drejtë të merrni informacion të plotë mbi perfitimet e ushqyerjes me gji për veten dhe fëmijën tuaj. Kjo do t'ju ndihmojë të bëni një zgjedhje të mirëinformuar sesi ta ushqeni beben tuaj.

Ju keni të drejtë të merrni informacion pa interesa tregtare dhe që përfshijnë:

- Si përfitonin ju dhe fëmija nga ana nutricional, mjekësore dhe emocionale nëpërmjet ushqyerjes me gji.
- Si ta përgatitni veten për ushqyerjen me gji.
- Si ti kuptoni disa nga problemet që mund të keni dhe si ti zgjidhni ato.

(2) Në qendrën e kujdesit shëndetësor të nënës

- Ju keni të drejtë ta mbani fëmijën tuaj pas lindjes, pavarësisht nga mënyra e lindjes. Mund të filloni ta ushqeni me gji një orë pas lindjes.
- Ju keni të drejtë të keni një person të trajnuar që tju ndihmojë me ushqyerjen me gji dhe t'ju informojë.
- Ju keni të drejtë të mos pranoni ushqyerjen e fëmijës me biberon apo shishe të tjera





- Ju keni të drejtë të informoheni dhe të mos pranoni ilace që mund t'ju ndërpresin qumështin.
- Ju keni të drejtë ta mbani fëmijën në dhomën tuaj 24 orë në ditë.
- Ju keni të drejtë ta ushqeni fëmijën me gji në cdo moment të ditës apo natës.
- Ju keni të drejtë ta dini nëse doktori juaj apo pediatri i fëmijës këshillon mosushqyerjen me gji para se të merren vendime në lidhje me ushqyerjen.
- Ju keni të drejtë të vini një shenjë ne krevatin e bebes tuaj që tregon qartë se fëmija juaj ushqehet me gji dhe nuk lejohen biberona apo mjete të tjera.
- Ju keni të drejtë të merrni informacion të plotë në lidhje me mënyren sesi po e ushqeni fëmijën me gji dhe të merrni ndihmë si ta bëni më mirë.

- Ju keni të drejtë ta ushqeni fëmijën me gji në pavionin e kujdesit intensiv të të sapolindurve. Nëse ushqyerja nga ju nuk është e mundur, do të bëhet cdo përpjekje që fëmijës ti jepet qumësht i shtrydhur nga gjoksi juaj.
- Nëse ju, apo bebja juaj, shtroheni përsëri në një qendër tjetër të kujdesit mjekësor pas daljes nga qendra ku u bë lindja, spitali do të bëjë cdo përpjekje që të vazhdojë ushqyerja me gji, të sigurojë pajisjet për shtrydhjen e gjirit dhe shërbimet në dhomë.
- Ju keni të drejtë të merrni ndihmë nga një person i specializuar për të ndihmuar në ushqyerjen me gji dhe shtrydhjen e gjirit nëse fëmija juaj ka nevoja të veçanta.
- Ju keni të drejtë të kërkonit që një anëtar i familjes të marrë informacion mbi ushqyerjen me gji.

(3) Kur largoheni nga qendra e kujdesit shëndetësor të nënave

- Ju keni të drejtë të merrni informacion të printuar në lidhje me ushqyerjen me gji, pa material tregëtar.
- Ju keni të drejtë, përveç rasteve kur kërkohet specifikisht nga ju, dhe është i disponueshëm nga qendra shëndetësore, të largoheni nga qendra pa marrë paketën që përmban ushqim fëmijësh apo receta me këto ushqime, nëse nuk kërkohet nga ofruesi i kujdesit shëndetësor të fëmijës.
- Ju keni të drejtë të merrni informacion për burime të ushqyerjes me gji në komunitetin tuaj, duke përfshirë informacionin në lidhje me konsultuesit e ushqyerjes me gji, grupet mbështetëse dhe shtrydhëset e gjirit.
- Ju keni të drejtë që qendra mjekësore t'ju japi informacion që t'ju ndihmojë të zgjidhni një ofrues kujdesi shëndetësor për fëmijën dhe të kuptoni rëndësinë e kontrolleve të vazhdueshme.
- Ju keni të drejtë të merrni informacion në lidhje me nxjerrjen e sigurt të qumështit nga gjiri dhe ruajtjen e tij.
- Ju keni të drejtë ta ushqeni fëmijën tuaj në cdo vend, publik apo privat, ku jeni i autorizuar që të qëndroni. Ankesat mund t'i drejtoni tek Departamenti i Shtetit të Nju Jorkut për Të Drejtat e Njeriut.

Të gjitha të mësipërmet janë të drejtat tuaja. Nëse qendra e kujdesit shëndetësor nuk i respekton këto të drejta, ju mund të kërkonit ndihmë duke kontaktuar Departamentin e Shtetit të Nju Jorkut për Shëndetin ose duke kontaktuar me kujdesin ndaj klientit të spitalit në numrin: **1-800-804-5447** ose me anë të emailit në adresën **hospinfo@health.state.ny.us**.